
VLERËSIMI TURISTIK I OFERTËS KULTURORE DHE NATYRORE TË RRETHIT TË KUKËSIT

BLERTA AVDIA

Universiteti i Tiranës

Email: blerta.avdia@hotmail.com

AKTET VI, 3: 254 - 258, 2013

PERMBLEDHJE

Turizmi vitet e fundit po merr prioritete të mëdha si rezultat i vlerësimit gjithnjë në rritje të vlerave natyrore dhe kulturore. Rrethi i Kukësit ka një pasuri të madhe natyrore dhe kulturore. Pozicioni strategjik midis rrugëve që lidhin brendësinë e trevave Ilire shqiptare me brendësinë e gadishullit të Ballkanin Qendrore dhe me gjere, kanë bërë që ky rreth të popullohet që në kohët e hershme duke lënë gjurmët e tyre. Potenciali turistik favorizon zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit. Evidentimi i kontrasteve të pasurive kulturore dhe natyrore, rëndësia e njohjes dhe vlerësimit të ofertës turistike në funksion të turizmit të qëndrueshëm, problemet me të cilat po përballlet oferta turistike, mundësia e menaxhimit të Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore për një zhvillim turistik të qëndrueshëm përbën thelbin e kësaj kumtese. Ky studim ndihmon për ndërgjegjësimin e komunitetit të rrethit të Kukësit dhe në dhënie të alternativave për menaxhimin e kësaj hapësire.

Fjalët kyçe: Turizëm, trashëgimi Kulturore dhe Natyrore, zhvillim i qëndrueshëm, menaxhim

Turizmi vitet e fundit po merr prioritete të mëdha si rezultat i vlerësimit gjithnjë në rritje të vlerave natyrore dhe kulturore, pririteti që po i jep shteti Shqiptar këtij sektori ekonomik.

Rrethi i Kukësit posedon të gjithë potencialin e mundshëm për zhvillimin e turizmit duke gërshtëuar pasurinë natyrore dhe kulturore. Relievi i shumëllojshëm, uji e bollshëm, liqeni, lumi, burime e shumta, klimën dhe mikroklima, malet, pyjet, livadhet alpine, bjeshkët, krijojn kushtet të përshtashme për zhvillimin e turizmit. Trashëgimia e pasur materialo-shpirtërore, izolimi i gjatë dhe mosnjohja e tij e bëjnë këtë rajon tepër tërheqës dhe atraktiv për pushuesit, turistët avanturierë etj. Nw rrethin e Kukesit mund tw zhvillohen këto lloje turizmi: malor, veror, peizazhor, kulturor.

Turizmi malor

Relievi i rrethit të Kukësit dallohet për një larmishmëri në aspektin morfologjik, morfogjenetik dhe kontrastet të mëdha

hipsometrike, ky i fundit ka pasur një ndikim të rëndësishëm në modelimin e relievit, të klimës, dukurive ambientale që në tërsinë e tyre bëjnë më komplekse dhe interesante peisazhet.

Këto tipare luajtën një rol të rëndësishëm në formimin e dukurive të veçanta natyrore të cilat theksojmë:

- Shfaqjen e ekosistemeve të përbëra nga shoqërime interesante të botës bimore dhe shtazore që ka vlera shkencore, ekologjike meritojnë të marrin statusin e zonës së mbrojtur.
- Zhvillimi i proceseve të erozionit dhe dinamika e proceseve ekzogjene ka çuar në krijimin e formave dhe mikroformave të relievit me vlera e monumenteve të natyrës
- Oferta e pasurive e potenciale klimatike favorizojnë zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, sporteve dimërore, në të njetën kohë ofron dhe mundësi për zhvillimit e lëvizjeve turistike në dhe pranë objekteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Këto tipare gjeografike kanë ndikuar në formimin e një natyre tepër të ndërlukuar me zhvillim të vullshëm, që ka çuar në formimin e vlerave të veçanta, unikale, që kushtëzojnë një trashëgimi shumë të pasur natyrore. Këto vlera unikale të natyrës kanë bërë që të evidentohen peisazhe me vlera të veçanta, të cilat kanë marrë statusin e Zonës së Mbrojtuar, kategoria e Monumenteve të Natyrës. Me VKM nr. 676, datë 20.12.2002, janë shpallur 16 objekte si monumente të natyrës, nga të cilat 16 Monumente Natyre si: gjeomonumente, biomonumente dhe hidromonumente.

Kjo pasuri natyrore e pranishme në rrethin e Kukësit merr vlera akoma më të mëdha nëse do të integrojmë me trashëgimin kulturor të trashëguar brez pas brezi dhe e vendosim në shërbim të turizmit.

Turizmi malor përfaqësohet nga këto aktivitetet sportive :

Alpinizmi

Alpinizmi është një sport dimëror i bukur. Pllajat e bukura të Novosejt dhe Shishtavecit janë shumë të përshtatshme për zhvillimin e sportit të skive gjatë dimrit. Si pista argëtuese janë përdorur rrugët kryesore të fshatit. Në kuadër të këtij sporti në vitin 2000 dhe 2013 u organizua një kampionat ndërkombëtar i skive ku morën pjesë skiatorët vendas dhe skiator nga Norvegjia dhe Gjermania.

Hipizmi

Është një sport i zhvilluar hershëm traditë më shumë për zonën e Gorës, në zonën e Dollovishtit dhe në rrethinat e Prizrenit. Kuajt garues ka patur në Novosoj, Shishtavec, Borja. Kuajt për hipizëm janë ruajtur në regjim stallor e me një përkudësje të veçantë duke ushqyer me orare të caktuara. Hipizmi është zhvilluar më shumë në rastet dasdash dhe festash tradicionale.

Mundja

Është një ndër sporte që tërheq jo vetëm turistët por edhe vendasit të të gjithë grup moshave. Uniforma e tyre ka qënë e veçantë që quhej kysmete dhe me rripin e gjërë dhe të zbukuruar me pulla të shëndritshme. Pelivanët (mundësit) para ndeshjes lyenin trupin me vaj për të penguar kapjen nga kundërshtari, ndeshja përcillej nga

lodra (tupanët). Ky lloj sporti ka qënë i përhapur në të gjithë rrethin e Kukësit.

Turizmi peisazhor

Në rrethin e Kukësit ofrohet kategoria e tretë e zonave të mbrojtura, Monumentet e Natyrës: Mështekna e Shishtavecit, Guri i Mëngjesit, Kroi i Kuq, Guri i Shqipës, Pylli i Dushkut në Novosej, Gryka e Çajës, Cirku akullnajor i Zepës, Vargëmalin Koretnik-Gjallicë- Kolesian- Kallabak-Tërfojë etj.

Të impresionojnë jo vetëm më madhështinë e tij, vlerat shkencore, por dhe me pasurinë e bjeshkëve të pasura për verim me vlera curative. Të gjitha këto ofrojnë mundësi të mira për të kënaqur vizitorët dhe të apasionuarit ndaj natyrës dhe vlerave kulturore të zonave etnografike ku ato bëjnë pjesë.

Turizmi kulturor

Pozicioni në udhëkryqet e rrugëve mesjetare dhe më të reja, kanë bërë të mundur që ky rajon të popullohet që në periudhat e hershme duke na lene trashëgim një pasuri të madhe kulturore. Rrethi i Kukësit ka një trashëgimi të pasur material-shpirtërore. Monumentet Kulturore të shpallura në këtë zonë janë 9 monumente nga të cilat 6 të karakterit arkeologjik, 3 të karakterit historik dhe 1 të karakterit arkitekturorë.

Të dhënat arkeologjike kanë vërtetuar se pellgu i Kukësit është banuar që në shek. I të erës sonë. Sipas këtyre të dhënave vërehen këto periudha historike të neolitit, bronzit, hekurit që dëshmojnë lashtësinë e këtij vendbanimi. Vendbanimet me të lashta janë të Kolshit, Kënetës, si dhe tumat ilire në Qınamak, Bardhoc. Vende të tjera të vizitueshme arkeologjike janë: Kështjellën e Vilës, Kështjellën e Pecës, Hisari i Domajve, Gradishta e Bardhocit, Kështjella e Bushatit dhe kodërvarret në Çınamak dhe të Kenetës.

Mbi emrin e qytetit të Kukësit ka mendime të ndryshme nga autorë të ndryshëm, por ka një shpjegim shkencor arkeologjik: në Kodrën e Pecës në fshatin Përbreg është gjetur mbishkrimi OYEKEIS që mund të lexohet UEIKEIS ose KUEIKEISI që të kujton emrin Kukës. Banorët e

lashtë të kësaj treve sipas Beb Jubanit i quanini "Ilir Alpin".

Ky rreth krahas vlerave arkeologjike ka vlera të çmueshme historike.

Më e spikatur është lufta e popullit të Lumës ndaj serbeve të zhvilluar në qafë të Kolosianit. Shkolla muze e Kolesianit (më 11 Tetor 1911), shkolla e parë shqipe e ngritur në godinë e ish mejtepës. Kjo ndërtesë merr vlera për karakterin shumëfunktional si në aspektin arsimor dhe atë patriotik.

Trashëgimia arkitekturore zë një vend të veçantë duke na shpalosur dhe një herë trashëgiminë e pasur të këtij rrethi. Monumentet arkitektkonike mund të klasifikohen në dy kategori kryesore: ndërtesa ku u zhvilluan *ngjarje të rëndësishme historike* dhe *përmendore që i detikohet figurave të rëndësishme historike*.

- Shtëpi të tipit Kullë (Kulla e Shaqir Palushit në fshatin Bushtricë, kulla e Ismail Aga Lumës në fshatin Bicaj ishin banesa të rëndësishme për patriotët gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit).

- Kulla e Rezistencës që gjendet në qytetin e Kukësit (në të cilën kremtohet mikpritja e ngrohtë e qytetarëve të Kukësit ndaj vëllezërve Kosovar)

Etnografia është një element i spikatur në rrethin e Kukësit, që rrallë mund të gesh ndonjë vend me një sipërfaqe kaq të vogël një gërshetim të tri zonave etnografike me tradita, zakone, veshjet tradicionale të veçanta: Krahina Etnografike e Malziut, Krahina Etnografike e Lumës, Krahina Etnografike e Gorës. Krahina e Gorës ka karakteristika të veçanta, popullsia dy gjuhëse: shqipen dhe Gorane (një dëgëzim i sllavishtës), veshja e tyre ndryshon nga ajo e krahinës së Lumës dhe Malziut pasi është më e pasur, më e larmishme dhe më figurante. Historia rreth origjinës së tyre, traditat e zakonet e tyre, mënyra e gatimit të gjitha këto e shtojnë turistin të vizitoj këtë rreth dhe ta vlersojë atë.

Në këto krahina gastronomia paraqet një interes të veçantë për turistët, vizitorët eskursionistët dhe kalimtarët e rastit që frekuentojnë këtë zonë dhe që herës tjetër do të jenë visitor për ta njohur atë.

Turizmi rural

Ky lloj turizmi ka mundësi të zhvillohet falë pasurive të shumta natyrore dhe kulturore që përmbajnë zonat rurale, ku janë të ruajtura dhe mbajtura gjallë traditat, zakonet, ritet etj. Zonat tipike ku mund të zhvillohet turizmi rural janë zona e Shishtavecit, Bicajt, liqenit të Fierzes. Bashkë me zhvillimin e Turizmit rural del në pah dhe turizmi gastronomik, i cili është elementi që prek nga afër zonën në të cilin spikatin gatimet tradicionale të rajonit si: peshku i liqenit *Lucipern*, *raki* shtëpie të prodhuar nga rrushi ose kumbulla, boza e famshme. *Djathi i bardhë i delevev (Çajës)*, kos i famshëm i Kroit të Kuq, *mjalti i gështenjave*, mish *i tharë*, *i pjekur*, *flija*, *petë misri*, *pite (Byrek)*, etj.

Turizmi fetar

Ka një pasuri të madhe të objekteve fetare, të cilët paraqesin interes të veçantë për turistët. Madhështia e tyre, legjendat, histori për shpëtimin e njerzëve dhe zgjidhja e problemeve janë elementët, të cilët tërheqin vizitorët në këtë rajon: Teqja e Dërvish Ismailit (Buzëmadhe) në fshatin me të njëjtin emër, Teqja e Sheh Kadrisë (Shtiqën).

Problematika që shoqëron zhvillimin e turizmit në rrethin e Kukësit

Zhvillimi i turizmit po shikohet gjithmonë dhe më shumë si prioritet për zhvillimin ekonomik dhe social të rrethit të Kukësit. Vizioni i këtij rrethi është *"Kukësi si një qendër rajonale përgjatë korridorit lindje-Perendim, me prosperitet ekonomik, i cili projektton të ardhmen mbi bazën e vlerave territorial dhe shfrytëzimit të mençur të potencialeve ekonomike të tregtisë, agrobiznesit, tokës, turizmit malor dhe kulturorë, mjedisit të pastër dhe burimeve të çmuara natyrore. Me një klimë të favorshme për fuqizimin e bizneseve dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore gjë që rrit mundësinë e punësimit dhe tërheqjen e investimeve brenda dhe jashtë vendit. Duke evidentuar simbole që përbëjnë thelbin e ekzistencës dhe të identifikimit.*

Megjithatë zhvillimi i turizmit është një sfidë për rrethin e Kukësit, pasi siç është e vërteta nuk është nga ata qytete që kanë pasur të zhvilluar tuzimin si Berati, Gjirokastra etj.

Turizmi në këtë rreth haset me problematikën e identifikimit të pasurisë natyrore dhe kulturore, promovimin dhe menaxhimin e saj në shërbim të turizmit si mundësi e gjenerimit të të ardhurave dhe aktiviteteve ekonomike (punishte artizanale, restorante me gatime tradicionale dhe hostel për qëndrimin e turistëve) për popullsisinë e zonës. Një punë e madhe duhet të kryhet dhe në ndërgjegjësimin e popullsisë, se dhe në rrethin e Kukësit mund të zhvillohet turizmi, në disa lloje të tij dhe mund të shërbej si instrument për krijimin e të ardhurave. Sot zhvillimi i turizmit në rrethin e Kukësit po probleme të shumta dhe tepër të shqetësuese të lidhur me faktorët natyrore dhe njerzor: me mungesë e një zyre informacioni në komunë, bashki ose pranë këtyre objekteve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, mungesë e marketingut dhe promovimit të vlerave të këtyre zonave, në njohjen e konceptit të zonave të mbrojtura dhe vlerat e tyre; mangësi në përgatitjen e strategjive dhe planeve për njohjen, mbrojtjen, menaxhimin e zonave të mbrojtura; mos promovimi i pasurisë kulturore të zones, mungesa e njohurive nga popullsia për mundësitë e zhvillimit të turizmit etj

Nga analiza e mësipërme vërejmë se problematika e pranishme në rrethin e Kukësit ka ardhur si rezultat i mungesës së menaxhimit të pasurisë natyrore dhe kulturore që ka rrethi :

- Objektet e trashëgimisë kulturore janë rikonstruktuar për herë të fundit 30 vite më parë nga autoritetet shtetërore;
- Mungesa e një kalendari të aktiviteteve festave pagane, tradicionale, turistike, në vende ku organizohen këto ngjarje;
- Mungesë e infrastrukturës turistike nuk ka as shenja, as shpjegim/përkthim, mungon ciceroni pranë vendeve arkeologjike;
- Mungesë e pranisë së rrethit të Kukësit në itinerareve të agjensive turistike vendase dhe të huaja për tri arsye: 1- nuk ka

informacion dhe shpjegim rreth vendeve arkeologjike; 2- shumica e interesuar në Shqipëri kanë tendencë të vizitojnë Gjirokastrën, Beratin, Butrintin, 3-për shkak të propogandës që bëjnë vendet e huaja

- Pasuria natyrore dhe kulturore është shumë pak e njohur nga popullsia lokale, është privilegj i studiueseve të zonës së fushave të ndryshme.

Po çfarë është bërë deri tani?

- *Evidentimi* i pasurisë natyrore dhe kulturore që ka rrethi duke e bërë të njohur së pari për popullsinë vendase dhe më pas për turistin dhe vizitorët e ndryshëm studiues, aventurier, eskursionistët etj.;
- Po bëhen përpjekje në rang rajonal, lokal për promovimi e ofertës turistike, megjithëse kjo nuk ka arritur në nivelet që kërkohet. Kjo shikohet të numri i ulët i turistëve që vizitojnë rrethin dhe se sa është e pranishme zona në itineraret turistike;
- Po bëhen përpjekje për realizmin e planeve dhe strategjive;
- *Monitorimi* i situatës është një proces i vështirë për tu realizuar në realitet shqiptar, aq me tepër në rrethin e Kukësit. Në këtë aspekt një rol të rëndësishëm kanë luajtur OJQ, UNDP dhe këshilli i Qarkut Kukësit;
- Krijimi i një qendre të informacionit ku të merren të gjitha informacionet e nevojshme mbi zonën e mbrojtur;
- Ngritja e vetëdijes për mjedisin dhe angazhimi i strukturave për avancimin e saj, po ndikon në përmirësimin rrënjësor të gjendjes në mjedis;
- realizimi i shkëmbimeve të eksperiencave ndër-institucionale midis vendeve me kushte të ngjashme.

Rëndësia e këtij studimi qendron në faktorët e mëposhtëm:

- Burim informacioni shkencor për shumë shkenca: gjeologjinë, gjeografinë,

gjeomorfologjinë, hidrologjinë, biologjinë, historinë etj.;

- Burim i sigurtë të ardhurash finaciare nëse kjo pasuri natyrore dhe kulturore do të mirëmbahen, mbrohen, studiohen dhe propogandohen vlerat e tyre;
- Turistët janë të interesuar që të njihen me kuriozitet e natyrës, kulturës prandaj dhe i vizitojnë ato, duke paguar dhe taksën e vizitës;

Konkluzione dhe Rekomandime

- Të ndërgjegjësohet popullsia vendase për mundësinë e gërshetimit të pasurisë natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit në rrethin e Kukësit dhe ta shikojë atë si prioritet të ekonomisë
- Të mos mungojnë elementet e Trashëgimisë Natyrore dhe kulturore në guidat turistike.
- Të rregullohet infrastruktura rrugore dhe ajo turistike që turisti të ketë mundësi t'i shikojë nga afër,
- Nëse promovohen siç duhet dhe restaurohen monumentet historike mund të tërheqin një numër të konsiderueshëm vizitorësh, kryesisht nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria;
- Potenciali turistik që ofron rrethi favorizon zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit malor, verorë, dhe kulturore, historik, arkeologjike, fetar etj. Ky potencial do të sjellë përfitime për banorët vendas, njëherazi mundësi që përmes turizmit popullsia të sigurojë të ardhura.

REFERENCA

1. Gjeografia Fizike e Shqipërisë (Physical Geography of Albania), 1990, 1991 Vol. I.dhe II Tiranë
2. Dragoti N., Dedej Z., Abeshi P., 2007. Zonat e mbrojtura të Shqipërisë (Protected areas of Albania). Tiranë
3. Dida M., Dragoti N., Kromidha G., Fierza Gj., 2004. Zonat Natyrore të Shqipërisë. Parqet kombëtare. Tiranë
4. Dollma M. 2006. Geography 3. Cultural and Natural Heritage, a book for Medium School. Tirana
5. Noka H. 2004. Një Guidë për Kukësin.
6. Qiriaz P., Hoxha G., Kola B., 2007. Gjeografia 3, libër për shkollat e Mesme. Tiranë
7. Qiriaz P., Bego F., 1999. Monumentet e Natyrës të Shqipërisë. Tiranë
8. Serjani A., Heba G. 1996. Gjeotrashëgimia në Shqipëri, Studime gjeografike Nr.9. Tiranë
9. Serjani A., Neziraj A., W. A. P. W Imbledon, Onuzi K., Hallaçi H., Bushati S., 2003. Gjeomonumentet dhe Gjeoturizmi në Shqipëri (Geological Heritage and Geotourism in Albania). In both: Albanian and English versions. Tirana
10. Avdia B., Serjani Afat. 2010. Gjeomorphologic Landscape Around Shkodra Lake and Their intergration with Cultural Heritage. Shkodër
11. Avdia B., Gjeomonumentet dhe Trashëgimia Kulturore si Mundësi për Zhvillimin e Gjeoturizmit në Rrethin E Kukësit, Mitrovicë 2011
12. Avdia B., Gjeomonumentet dhe Trashëgimia Kulturore si Mundësi për Zhvillimin e Gjeoturizmit dhe turizmit në Krahinën e Lumës dhe Gorës, Tiranë 2012..